

VENDIM
Nr. 325, datë 23.6.2000

PËR KRIJIMIN E QENDRËS KOMBËTARE “PËR MIRËRRITJEN, ZHVILLIMIN DHE REHABILITIMIN E FËMIJËVE”, SI NJËSI BUXHETORE, E VEÇANTË
(Ndryshuar me VKM nr. 558, datë 15.7.2020)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 29, të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998, “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit të Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 13, të ligjit nr.8554, datë 10.12.1999, “Për buxhetin e shtetit të vitit 2000”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shkëputjen e *Qendrës Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët* nga Drejtoria e Shëndetit Publik, Tiranë, qytet dhe përcaktimin e saj si njësi buxhetore kombëtare të veçantë, në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë.

2. Drejtorisë së Shëndetit Publik, Tiranë, qytet, i pakësohen në numrin e punonjësve 67 punonjës, të cilët i shtohen *Qendrës Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët*.

2.1 *Qendra Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët është institucion që ofron shërbime të shëndetit mendor, në lidhje me diagnostikimin, trajtimin, kujdesin terapeutic dhe rehabilitimin e aftësisë së kufizuar për fëmijët.*

2.2 *Drejtori i Përgjithshëm i Qendrës Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët emërohet, lirohet ose shkarkohet nga ministri përgjegjës për shëndetësinë.*

2.3 *Shërbimet ofrohen nga ekiye multidisiplinare të përbëra nga specialistë të disa fushave, si: mjekë, infermierë, psikologë, punonjës socialë, terapistë okupacionalë, logopedistë, terapistë zhvillimi, ergoterapistë, fizioterapistë, terapistë psikomotorë dhe specialistë të tjerë të profilin mjekësor, të cilët veprojnë në mënyrë të koordinuar, sipas roleve dhe përgjegjësi të përshtatshme në rregullorën e brendshme të institucionit.*

2.4 *Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e Qendrës Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët, udhërrëfyesit dhe standardet e kujdesit shëndetësor e social miratohen nga ministri përgjegjës për shëndetësinë.*

3. Efektet financiare, që lindin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i miratuar për vitin 2000, për Ministrinë e Shëndetësisë.

4. Ngarkohen Ministria e Financave, që, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë, të ndjekë procedurat e nevojshme për kalimin e fondeve buxhetore dhe për krijimin e strukturës së re buxhetore për këtë qendër.

5. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Illir Meta